



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.02.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar **Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

|                                                     |                                     |
|-----------------------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>RAHOVEC / ORAHOVAC</b>                           |                                     |
| Njësia Nr./Br./No <u>01</u> (Kuvendi i Komunës)     |                                     |
| Nr./Br./No <u>01/133</u>                            | Nr. i faq./Br.str./No. pg <u>16</u> |
| Data/Datum/Date <u>29</u> / <u>03</u> / <u>2021</u> |                                     |

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2020,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa komunale 01 Nr.80/20, të datës:20.06.2020,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P – 71510057 – 01687-3 në zonën kadastrale në Rahovec,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për lirim nga taksa komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Rahovecit,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për lirim nga qiraja mujore për bizneset dhe personat fizik të cilët shfrytëzojnë pronën e paluajtshme të Komunës,
8. Informatë për zonën e mbrojtur “Kanioni i Drinit të Bardhë tek Ura e Fshenjtë”,
9. Plotësim ndryshimi i vendimit për emërtim të rrugëve dhe shesheve,
10. Vendim për shfuqizimin e vendimit për fshatin Pastasel,
11. Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit si institucion edukativo-arsimor.

### Pikat Shtesë

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr. 165/21, të datës 29.01.2021 për shpalljen me interes të përgjithshëm në zonën kadastrale Pastasel.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.149/20, të datës 29.12.2020, për miratimin e listës për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.
3. Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit, drejtoreshës dhe zëvendësdrejtoreshës si institucion edukativo arsimor.

Të nderuar kolegë kuvendarë, a pajtoheni me rendin e ditës me pikat shtesë?

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Në fakt kishte si Kuvend dhe gjithë anëtarët e kuvendit jemi për me punua dhe të gjitha pikat që na vijnë do t'i kryejmë, pasi këtë detyrë e kemi.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Fazliu, atëherë e qesim në votim rendin e ditës me pikat shtesë. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikat shtesë. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

#### **1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, nuk do të ndalem shumë në korrigjime mirëpo është një lëshim përmbajtësor në faqe 17 në diskutimin tim që është gabim në shifër dhe do të ishte mirë të përmirësohet, pasi aty është e shkruar 174,113 dhe duhet të përmirësohet e të bëhet 1,074,113 euro.

**Kryesuesi** – Atëherë meqë nuk kemi tjetër të lajmëruar, e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

#### **2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.**

**Sali Sallteku** – Përshëndetje për të gjithë. Unë dua të falënderoj kryetarin e komunës për punën që ma ka kryer në fshatin Malësi të Vogel edhe pse me vonesë mirëpo e falënderoj për premtimin e dhënë. Por tani kam një kërkesë për kryetarin dhe drejtorin e arsimit që me vendos edhe rrethojnë gjatë gjithë asaj pjesë.

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive dhe gjithë ju kolegë asamblistë. Unë desha me ngritë dy çështje, e para ka të bëjë që pas ngritjes së shqetësimit të disa studentëve që mu kanë drejtuar mua, fjala është për pjesën e nënkalimit që po bëhet në Xerxe, ka mbet shumë pak hapësirë për këmbësorë në atë pjesë dhe ajo po shkakton vështirësi dhe njëkohësisht edhe rrezik në atë pjesë dhe kërkesa ime është me pas mundësi të paktën në atë pjesën afër rrugës me mbushë me zhavor që këmbësoret mos me u rrezikua nga makinat sepse me të vërtetë është hapësirë e ngushtë aty. Çështja e dytë që desha me ngritë është një kërkesë nga këshilli organizativ për dhurimin e gjakut por edhe nga qytetarët që dhurojnë gjak qoftë në Ratkoc, Dejnë edhe në vende tjera, është rishqyrtimi i mundësisë nga ana e drejtorisë së shëndetësisë dhe drejtorisë së Financave që këta qytetarë që dhurojnë gjak me u lirua nga taksa e participimit në shëndetësi, pasi nuk është një shumë e madhe për participim por është një vlerësim për kontributin e tyre që dhurojnë gjak, pasi dikush dhuron edhe më shumë se njëherë gjak brenda vitit dhe është një vlerësim për kontributin e tyre. Kështu që do të ishte mirë që ta shqyrtoni si mundësi, se sa impakt në të hyrat e drejtorisë së shëndetësisë edhe e vlerësoni se a është e mundur me u bo apo jo, dhe nëse është e mundur atëherë në seancat e tjera në mundemi me ndryshua rregulloren për taksa që a me i lirua me një vendim të veçantë këta qytetarë.

**Masar Popaj** – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë dhe gjithë ju kolegë asambleistë. Unë desha të ngris një çështje për pjesën që të gjithë e dinë përgjatë rrugës kryesore Xërxë-Fortesë e cila duket si liqen artificial, se pse ajo pjesë nuk është zgjidhur ende dhe nuk janë kulluar ato ujëra.

**Kryetari** – Përshëndetje për Kryesuesin, nënkryetarin, drejtoret e drejtorive, anëtarët e kuvendit, përfaqësuesit që e përcjellin këtë seancë apo këtë mbledhje të rregullt të kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm. Çështjen që e ka ngritë kuvendari Sali Sallteku, unë besoj që deri sa janë bërë kufizimet apo matjet, ne mundemi të planifikojmë edhe një rrethojë por jam tepër i sigurtë që nëse jemi në rregull me dokumentacion deri sa unë jam kryetar i komunës nuk do të këtë mundësi me marr askush atë prone dhe për këtë ju siguroj publikut, kuvendarëve që nuk do ta lejojmë një gjë të tillë, Nëse ka pretendime të tilla që me marr, ne sigurisht që nuk do ta lejojmë pavarësisht pretendimeve nëse është gjithçka në rregull me dokumentacion, por nëse është nevoja edhe njëherë e shpallim dhe e mbrojmë me vendim të kuvendit të komunës, kështu do ta analizojmë edhe njëherë me drejtorin e gjeodezisë dhe stafin qeverisës se a ka nevojë edhe njëherë me përsërit vendimin për mbrojtje të asaj prone. Mirëpo pretendime sigurisht që ka dhe këtë e kam vërtetuar edhe unë vet por normalisht sipas pretendimeve të tyre që të paraardhësit e tyre dikur ja kanë falë komunës por nëse dokumentacioni figuron se është gjithçka në rregull si pronë e komunës atëherë sigurisht se do t'i japim epilog pozitiv kësaj situate. Pastaj, pyetja e drejtuar nga Ali Morina për nënkalimin në Xerxe, që është një projekt i Ministrisë së Infrastrukturës prej vitit 2015, i cili projekt ka pasur dhe vazhdon me pas probleme me pronën e hekurudhës por kontrata ekziston sepse jemi interesuar vazhdimisht për këtë çështje dhe vazhdimisht ju kemi dërguar shkresa Ministrisë së Infrastrukturës por si duket ata kanë probleme me bordin e hekurudhave që kanë vështirësi në zbatimin e kontratës për shkak të rezistencës që e krijojnë bordi i hekurudhave të Kosovës janë njëfarë institucioni, që gjithashtu ka edhe uzurpime të pronës siç është rasti me lokalit e qebaptores që realisht është uzurpim apo ka marr një pëlqim prej hekurudhave dhe ai pëlqim nuk e di a vlen ende se ka mundësi edhe i ka skaduar edhe afati, pasi një pjesë atij objekti përfshihet në projektin sipas kontratës dhe tash aty zgjidhja është shumë thjeshtë, nëse në kemi institucione vepruese duhet me ja rrënuar pjesën e objektit që uzurpuese. Kështu që ka probleme pronësore ose mospajtime konflikt midis bordit të hekurudhave dhe Ministrisë. Pra, qytetarët e Xërxes dhe komunës së Rahovecit duhet me ditë se ne nuk kemi kompetenca me vepruar aty dhe po të ishim në autoriteti kontraktues ndoshta jam i bindur se do të gjenim zgjidhje por pasi që nuk jemi atëherë ne nuk po mundemi me mbërriri në vendimmarrjen e autoritetit kontraktues e në këtë rast të Ministrisë së Infrastrukturës për me krye kontratën. Pastaj, rruga katër korsi që është projekt që realisht në jemi autoritet kontraktues e përfshin edhe atë pjesë dhe aty sigurisht që kemi mu ballafaqua me situata problematike por ndoshta për shkak të kompetencave që i kemi si autoritet kontraktues edhe për shkak të energjisë vepruese më të madhe që e kemi se sa ata tjerët por së paku nuk e kanë dëshmuar dhe vërtetuar që me u interesua me zgjidhje atë problem, po ashtu njëjtë e kemi edhe në Krushë të Madhe edhe pse nuk po ngritët si çështje me çështjen e rreth rrotullimit, pasi kontrata ekziston mirëpo zbatimi i kontratës është i paarritshëm për shkak të disa problemeve që lidhen qoftë me projektuesin e projektit apo me disa prona private pasi dikujt i është afruar deri objekti i shtëpisë e dikujt nuk e prek hiq. Pra ne kemi insistuar që 3 vjet dhe vazhdimisht insistojmë se mbeten në kod të buxhetit të Kosovës si kontrata që duhet me u zbatua mirëpo nuk zbatohen. Por këto nuk janë të 3 viteve të fundit por janë prej kohës kur ka qenë Ministër Lutfi Zharku pra janë koduar dhe është ndarë buxheti por nuk ka pasur asnjëherë veprim konkret për me u zbatua kontrata. Pastaj, te dhuruesit e gjakut, ne kemi probleme në realizimin e taksës në shëndetësi, pasi ka shumë kategori që janë të liruara por si propozim është me vend dhe i arsyeshëm sepse dhuruesit vullnetar të gjakut mendoj që duhet me pas një lehtësi, edhe pse është një shumë simbolike prej 1 euro si participim mirëpo edhe sipas informatave e kemi nuk është si mbledhet shumë nga ky participim e sigurisht se ka edhe tolerancë edhe prej stafit të QKMF-së, e po ashtu ka mundësi që veteranët e invalidët e luftës që nuk i kanë kartelat me vete edhe nuk paguajnë e sigurisht edhe plot kategori tjera sociale që nuk paguajnë sipas rregullores së kuvendit, kështu që ne mundemi me futë edhe këtë element edhe nuk i prishë asgjë punë buxhetit të Komunës respektivisht, kështu që unë jam për me i përkrah por ndoshta duhet me ndryshua edhe me plotësua rregulloren për taksa tarifa gjoba dhe

ngarkesa. Dhe taksat në shëndetësi edhe pse janë të parapara me udhëzim administrativ kuvendi i Komunës së Rahovecit meqenëse ka një traditë të dhurimit të gjakut kështu që ne mundemi dhuruesve të rregullt së paku me i lirua prej taksave në shëndetësi. Pra, duhet vendim i kuvendit të Komunës dhe plotësim ndryshimi i rregullores dhe besoj që në seancën tjetër në muajin mars mundemi me pa se qysh me gjet çelësin për me i dhanë zgjidhje me vendim të kuvendit. Pastaj, pyetja e parashtruar nga Masar Popaj, për tokat në ujë në Fortesë dhe Celinë, që realisht i kemi disa probleme në mes të Fortesës dhe Xërxes siç e dini që ka edhe ndërtime që janë në kundërshtim me ligjin e që kanë ndodhur më herët siç është ndërtimi i restorantit të dasmave që nuk ka leje e që nuk mundet kurrë me u pajisë me leje, pastaj edhe shumë ndërtime tjera pasi e kanë shkelë ligjin sepse kanë ndërtuar në Komasion kështu që leje ndërtimi nuk kanë, mundësi legalizimi me këto ligje nuk kanë dhe kjo është një argument që ndikon me u grumbullua uji aty. Pastaj, janë problemet që janë brenda fshatit Xërxë si restorant Adora ka ndërmarr veprime ndërtimore atëherë kur e ka ndërtuar restorantin edhe e ka futë një gyp shumë të ngushtë edhe ai gyp nuk mundet me përballua plot prurje të ujit. Kështu që ne kemi vendosur që bashkë me pronarin e Adores me i dhanë zgjidhje sepse ai nuk ka pasur të drejtë kur e ka kryer atë punë, pasi kanë ndodhur shumë veprime të kundërligjshme jo vetëm aty por edhe në shumë vende tjera që realisht e ka kufizua mundësinë e shkarkimit të ujërave atmosferik në atë pjesë. Po ashtu, ka edhe disa probleme pronësore që lidhen me hyrje të Xërxes tek Sillosi ku kanë ndodhur shumë veprime që realisht edhe ato ndikojnë, e po ashtu edhe ai ndërtimi që pat nisë me u bo e që ju pata premtua se nuk ka me lejua me u bo edhe pse është prone e tyre mirëpo ajo është në Komasion kështu që ne duhet të gjithë të bëhemi bashkë edhe mos me lejua sepse pastaj po krijojnë probleme edhe në familje edhe në biznese por edhe në tokat bujqësore. Po ashtu edhe fshatin Celinë kemi një situatë të ngjashme, kështu që sivjet parashohim me pas kanale të kullimit Fortesë-Celinë dhe Fortesë Xërxë, por gjithsesi duke zgjidhur problemet e shkarkimit të ujërave në pjesën ku është e banuar. Kemi probleme me pjesën e banuar të restorant Adora që është një gyp shumë ngushtë i cili nuk ka mundësi me realizua shkarkimin e ujërave të cilët shpesh herë janë shumë të mëdha se sa që mundet me i përballua gypi. Gjithashtu edhe unë kam kërkuar zgjidhje emergjente, së çka mundemi me bo që ai ujë kullua dikun por gjithashtu ka problem edhe me ramje sepse është e rrafsh ajo pjesa, kështu që meqenëse nuk ka, bile kanali që është hapur të M-Sillosi ka rrjedhë mirëpo të niveli është dashtë me harmonizua me ato që janë tek restorant Adora, kështu që sikur të ishte mundësia e zgjidhjes së problemit tek restorant Adora atëherë mundet me qenë rënia më e mirë. Pra është deshtë me pas harmonizimin pasi kam pyetur shumë inxhinier e projektues kështu që ka shumë probleme në atë pjesë prandaj edhe grumbullohet edhe uji edhe sigurisht që nuk ka mundësi me shkua askund. Po besoj që me hapjen e ndonjë kanali të kullimit që me i bo zgjidhje po gjithmonë duhet me pas parasysh që me i bo zgjidhje zonës së banuar. Këto ishin shpjegimet për çështjet që u ngritën, faleminderit edhe juve për kontributin.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Po dua me bo një ndërhyrje rreth këtij propozimi që e dha zotëri Aliu për lirim nga pagesa pranë QKMF-së dhe institucioneve tona shëndetësore për dhuruesit e gjakut me qëllim që të kontribuojnë sadopak. Kryetari e dha shenjë se ne do të jemi për këtë propozim, që gjithashtu edhe unë mendoj se nëse ka mundësi duhet që ta shqyrtojmë këtë mundësi mirëpo ju kujtoj se është udhëzimi administrativ që rregullon bash pagesën para institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor. Po ashtu, e kemi edhe rregulloren për taksat dhe tarifa e kemi shqyrtuar që vitin e kaluar ka pasur propozime për disa ndryshime mirëpo sa me kujtohet nuk na është lejuar. Por nëse ka mundësi, unë jam që si shtesë kisha me ju njoftua se më herët ka ekzistuar një udhëzim administrativ ku kjo kategori e njerëzve kanë qenë të liruar mirëpo kanë disa kritere p.sh. kush ka dhurua gjak me shumë se dhjetë herë mirëpo pastaj është ndryshuar kjo dhe me këtë udhëzim të fundit është larguar krejtësisht. Kështu që në të ardhmen ne mund të punojmë në këtë drejtim por duhet të kemi parasysh edhe këtë, që dhuruesit e gjakut edhe aty dallojnë pasi që dikush është i rregullt e dikush jo, kështu që duhet të kihen parasysh edhe ato rrethana.

**Sali Sallteku** – Po dua të ndërhy te fjalimi i doktorit që tha se edhe unë e di që nuk keni të drejtë këtu dhe një njëri që jep gjak nuk është edhe arsyeshme të merret me çështjen e një eurove, por unë jam i bindur që kuvendi i Komunës nuk ka të drejtë me bo dhe për këtë e tha edhe më herët shumë mirë doktori. Po ashtu, kryetar ju falënderoj për çështjen e adresuar nga unë, desha të shtojë edhe diçka tjetër se ai njëri nuk i ka dhënë diçka askujt por vetëm i ka marr. Dhe kjo që janë vendos pikat ka qenë pronë e shkollës dhe gjithashtu është pronë e shkollës.

**Kryetari** – Për sqarim veç thash pretendimi i tij, nuk e thash se është e vërtetë pasi ne kemi dokumentacionin.

**Ali Zhuniqu** – Çështja e udhëzimit administrativ nuk e di se si qëndron por personat që dhurojnë gjak i kanë disa përparësi në raport që kur vijnë në QKUK, nëse familjaret e tyre nuk sigurojnë doza atëherë merret direkt qendra e transfuzionit të gjakut dhe sigurohet nga ta, pra kjo është njëra prej atyre që mundën me marr si kontribut në kuadër të kësaj libreze. Tash për ndryshime sigurisht se duhet me shikua edhe udhëzimin administrativ që rrjedh prej Ministrisë së Shëndetësisë dhe nuk e di sa kish me qenë e mundur sepse realisht nëse vendoset një kusht deri në 3 herë, atëherë sigurisht se ka me qenë një motiv shumë i madh i qytetarëve që me dhanë deri në 3 herë gjak edhe me fitua të drejtën që me i krye këto shërbime.

**Kryetari** – Të them te drejtën unë pajtohem me Salinë pasi ata dhurojnë në mënyrë humanitare gjak por më mirë do të ishte me i dërgua në ndonjë pushim ata pasi se kur ta kuptojnë tjerët që po krijon një lehtësi komuna atëherë mundet edhe mu shtua numri i dhuruesve, kështu që e thash në kuptimin figurativ por mund me ju krijua një lehtësi tjetër pasi mundemi me ju dhanë një status nderi.

**Kryesuesi** – Faleminderit kryetar për sqarimet, të nderuar kolegë kuvendarë më qe nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2020.

**Afrim Limani** – Përshëndetje për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, asamblistë dhe gjithë te pranishmit në sallë. Shuma e mjeteve të bartura nga viti 2019-2020 në vitin 2021 në total është 506,707 euro që realisht asnjëherë ska qenë me e madhe deri me tash në 3-4 vitet e fundit. Këto mjete shuma prej 21,926 janë të dedikuara për Drejtorinë e Shëndetësisë konkretisht në pozicionin e pagave që janë pagua puna e mjekeve dhe infermiereve që kanë punuar jashtë orarit të punës në kujdestari ndërsa pjesa e mbetur në shumen prej 484,781 euro është e dedikuar kryesisht për investime kapitale dhe atë që ne i kemi dhënë sipas një analize të mirë të buxhetit dhe kontratave aktuale që gjithashtu jemi shkuar edhe sipas rekomandimit të auditorit që paraprakisht i kemi shlyer borxhet më të vjetra ndër vite që kanë qenë dhe pjesa e mbetur është e dedikuar kryesisht për kontrata që kanë obligime me të mëdha financiare. Shuma me e madhe e buxhetit është e bartur në kuadër të drejtorisë së infrastrukturës dhe drejtorive tjera duke mos lënë anash edhe drejtorinë e Arsimit, ku shumicën e kontratave me këtë bartje të hyrave në i mbulojmë kontratat dhe nuk kemi obligime ndaj këtyre kontratave p.sh. me duhet të potencoj ndërtimi i shkollës fillore Heronjtë e Kosovës, ndërtimi i shkollës fillore e Reti, ndërtimi i çerdhës në Krushë të Madhe, ndërtimi i çerdhës në Xerxe edhe riparimet në shkolla. Të nderuar asamblistë me siguri të plotë mundem me ju thanë që Komuna e Rahovecit në 3-4 vitet e fundit asnjëherë ska qenë në një gjendje me të mirë financiare karshi obligimeve kontraktuale që i kemi. Pra me këto bartje të mjeteve situata përmirësohet edhe me tepër gjithashtu presim edhe grantin e performancës në shumen prej 650,000 që e kemi fituar vitin e kaluar dhe brenda muajit mars apo prill të bëhet edhe alokimi i atyre mjeteve kështu që gjendja e komunës së Rahovecit është jashtëzakonisht stabile edhe asnjëherë s'ka qenë më mirë në 4-5 vitet e fundit. Andaj, për fund kërkoj nga ju që ta votoni këtë pikë të rendit të ditës dhe t'i shtohen komunës së Rahovecit edhe 506,000 euro.

**Kryesuesi** - Faleminderit shumë drejtor, ne e kemi shqyrtuar dhe trajtuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa edhe i kemi rekomanduar kuvendit, kështu që faleminderit nga ana juaj.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për shpjegimin që na dha rreth bartjes së mjeteve. Unë vetëm desha me bo një pyetje shtesë se edhe ashtu na dha një përgjigje që ato borxhe që i kemi

pasur ne listën e borxheve prej mbi 1 milion atëherë shumica e këtyre mjeteve shkojnë në ato projekte dhe atëherë unë them se emër të grupit të PDK-së e mbështesim bartjen e mjeteve për vitin 2021.

**Dervish Çadraku** – Përshëndetje për të gjithë. Ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e pata këtë kërkesë që një koleg i joni e tha pak me herët për ujërat që janë në mes të Xërxes dhe Fortesës edhe gjithashtu kryetari tha diçka rreth kësaj që realisht nuk ishte krejt konkret se çka do të ndodhë aty sepse me një kanal për kullimin e ujërave ajo tokë nuk lirohet prej ujërave. Mendoj që ka qenë një projekt i mëhershëm si lloj drenazhe që ka qenë në të dy anët e rrugës edhe unë mendoj se në kuadër të kësaj edhe pse tha drejtori që nuk kemi të drejtë që me i tërheq edhe me i qitë në një projekt apo me bo diçka konkrete këtu por megjithatë aty duhet një projekt që bën drenazhim bile të pjesëve kryesore që mbushen me ujë por e kisha inkurajua kryetarin që të merret më seriozisht me këtë punë sepse do një përkushtim që me bo një projekt dhe një punë të madhe që do t'i lironte ato toka nga ujërat që për çdo vite vërshohen masivisht nga ujërat atmosferike. Kështu që kisha propozua që një pjesë të shumës që kemi të mbetura ndoshta edhe drejtori e din ma mirë te ndërtimi i kanalizimeve ku kemi në kategorinë e investimeve kapitale ku e kemi në programin e shërbimeve publike që ndoshta mundemi me shti këtu te trajtimi i kanalizimeve që me i tërheq këto mjete prej këtu ose kemi ndërtimi dhe trajtimi i ujërave atmosferike.

**Kryetari** – Ne i mbulojmë kontratat me obligimet kontraktuale me këto mjete që bëhen dhe tash një pjesë e problemit mundet me u zgjidh me rrugën katër korsi që do të jenë kanalet në të dy anët e rrugës për shkarkim të ujërave pra rruga prej tranzitit te ri e deri në Xërxë do të jetë me kanale në të dy anët e rrugës. Kështu që nuk po them se e zgjidh plotësisht problemin por ajo është një kontratë e nënshkruar. Problemin më të madh te shkarkimi nuk e kemi që i përmenda edhe më herët te disa probleme pronësore që janë të shumta por problemi më i madh është te Restaurant Adora që është një gyp rreth 150 metra që e ka futë edhe e ka bo parking aty, pra pikërisht në atë vend është problemi që duhet me i dhanë zgjidhje që mos me zgjidh njëherë e përgjithmonë problemin e ujërave nëpër toka. Pra, thelbin e problemit e dimë por këto mjete nuk shkojnë në projekte të reja por në kontratat ekzistuese p.sh. kur i përmende kanalizimet që realisht ne kemi dy kontrata me kanalizim të ujërave të zeza. Pra, na nuk kemi te drejtë që nëse nuk është e paraparë me u zgjidhë një problem që nuk është pjesë e kontratës kështu që ne nuk mundemi me i thanë operatorit që shko zgjidhë atë problem që nuk është e paraparë në kontratë sepse është shkelle. Kurse për projekt të ri që ka paraparë Drejtoria e Bujqësisë një pjesë e ka zgjidhur aty ku është bërë ai kanali që e bart vetëm ujin e kodrave mbi shkollë ndërsa problemin e kullimit të ujërave që mbledhen nëpër toka të punës d.m.th. një pjesë zgjidhet me kontratën që kemi me rrugën katër korsi ndërsa pjesa me e madhe e problemit lidhet me atë që e përmenda më herët te Restaurant Adora që e ka fut një gyp shumë të ngushtë dhe është i papërballueshëm për kullimin e atyre ujërave dhe gjithashtu është e mbuluar me kubëza pasi që është i krijuar si parking. Kështu që duhet me gjet një marrëveshje me atë që ky defekt duhet me u riparua edhe me vendos një gyp më të madh dhe më të gjerë me bo kanalin në mënyrë që rënia me u rregullua që edhe ujërat e tokave te punës edhe të kodrave me pas mundësi me u shkarkua dhe me pastaj me shkua ka Drini i Bardhë, kështu që ky është zgjidhja e këtij problemi.

**Rasim Fazliu** – Unë mendoj që këto probleme janë të kamotshme me vite të tëra dhe ende nuk e kanë marr zgjidhjen e duhur por ajo që desha të them unë si kuvendarë, ne për çdo vit e bëjmë planifikimin e buxhetit për vitin në vijim dhe tash në shtator duhet me u aprovua buxheti për vitin 2022, edhe do ishte mirë edhe ne si anëtarë të kuvendit edhe ju si ekzekutiv që me i parapa këto dy gjëra, po flas tani për këtë pjesën këndeje Gradishit kurse për andej nuk jam shumë në ngjarje dhe nuk mundem me diskutue, po ashtu është mirë që edhe kjo çështje e ujërave në Xërxë të rregullohet dhe të parashihihen mjete për projektin e ri dhe ndërkohë edhe lumi Bellaja duhet me gjet formë dhe mënyra që me u trajtua që të shkoj uji në Dri dhe tokat e Celinës me kanalin që ju e keni ndërtua aty vetëm duhet me u vazhdua në të dy anët. Kështu që përndryshe nuk do të ketë

probleme me ujëra por këto dy gjera duhet me u trajtua edhe me u rregullua edhe mos me ekzistua këto probleme që janë ndër vite. Pra, me planifikimin e buxhetit që e kemi tash dhe atëherë duhet me dhanë kontributin edhe ne si anëtar të kuvendit por edhe ju si ekzekutiv me i paraparë këto sene dhe gjithashtu me i harmonizua edhe me bo zgjidhjen.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë për kontributin z. Fazliu, e qesim në votim edhe pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katër të rendit të ditës:

**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa komunale 01 Nr.80/20, e datës: 20.06.2020.**

**Isak Hoti** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin dhe gjithë ju te nderuar kuvendarë. Me propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve publike dhe me pastaj edhe me propozimin e Kryetarit të Komunës që është diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa ka ardhur si pikë e rendit të ditës ndryshimi dhe plotësimi i rregullores për taksa komunale me të cilin kanë kërkuar që neni 13 i rregullores të shtohet edhe një pikë me të cilën pikë lirohen nga taksa e parkingut bashkësitë fetare. Faktikisht është plotësuar neni 30 me pikën 7 dhe ky ndryshim plotësim do të jetë pjesë përbërëse e rregullores për taksa komunale.

**Fehmi Hoxha** – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtor të drejtorive, kolegë kuvendarë dhe gjithë ju te pranishëm. Vazhdimisht po na ndodhin që po na kthehen disa vendime prej MAPL-së për certifikim. Gjithsesi pajtohem që të lirohen të gjithë nga taksa bashkësitë fetare, mirëpo unë mendoj që duhet me qitë edhe organizatat joqeveritare për me kompletua këtë dokument edhe pse nuk kanë asnjë organizatë joqeveritare por që do të jetë më e lehtë për certifikim. Kështu që po ju sugjeroj për këtë pasi faktikisht është një grup pra janë OJQ-të dhe nuk kanë askush që mundet me përdor ndonjë vend parking mirëpo do të ishte mirë me qitë për shkak të certifikimit që faktikisht nuk po e bëjmë selektive por për të gjithë po e bëjmë. Pra, si propozim po e jap kështu që ju mendoni edhe vendosni.

**Përparim Krasniqi** – Të nderuar anëtarë të kuvendit, desha përmes zyrtarëve ligjor të mbrohet kjo pikë por paraprakisht dua të ju jap disa informata shtesë lidhur me një udhëzues që është në nivel të Kosovës për komunitet që paraprakisht i hedhin në rregulloren për taksa dhe tarifa për çështjen e lirim të taksave. Po ashtu edhe OJQ-të janë të përfshira si propozim në udhëzues mirëpo nëse keni ju si propozim atëherë ne me vendim e dërgojmë atje dhe nuk është problem. Ne kemi përvojë prej bashkësive fetare pasi ka pasur kërkesë për parkingje në pronat publike por nuk kemi pasur kërkesë prej OJQ-ve por nuk do të thotë që mos me i futë edhe ata si OJQ-të në këtë pikë.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, meqenëse kolegu Hoxha e pati një propozim për me i kontribua kësaj çështje edhe drejtori tha me herët se gjithçka në rregull është, kështu që ne si grup i PDK-së e mbështesim këtë plotësim të rregullores me propozimin që dha Fehmi Hoxha.

**Fehmi Cena** – Meqenëse ky është një propozim i ri pasi u tha që në mbledhjen për Politike dhe Financa e kishim propozimin vetëm për lirim për bashkësitë fetare, mendoj që është e logjikshme kjo kështu që në një punë të kryhen dy punë, por mendoj që kjo të qartësohet dhe kjo duhet të vlejë për veturat zyrtare të OJQ-ve, pasi ka shumë OJQ që nuk kanë veturë zyrtare dhe i shfrytëzojnë edhe veturat private dhe mos të krijohet paqartësi, pra fjala është për veturat zyrtare që e kanë firmën e OJQ-së. Kështu që mendoj se duhet të pajtohemi për këtë.

**Kryesuesi** – Faleminderit z.Cena, atëherë e qesim në votim pikën shtesë me propozimin e z. Hoxha. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

**5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P – 71510057 – 01687 – 3 në zonën kadastrale Rahovec.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit. Para jush keni vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P – 71510057 – 01687 – 3 në

zonën kadastrale në Rahovec. Bëhet fjalë për pronë private e cila është në emër të NTP.Agronomi,ku qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm me këtë sipërfaqe prej 81 m2 është që të hapim rrugë publike në atë pjesë, ku faktikisht aty është rrugë e kalueshme publike por kalon neper parcela private. Pra kjo është parcela e parë dhe gjendet në Rahovec. Bartës për rregullimin e dokumentacionit publik do të jetë Drejtoria për gjeodezi kadastrë dhe pronë. Bëhet fjalë me konkretisht të Kosova Petrol në drejtim të njëjtë me çerdhen Hareja,e cila është rrugë e kalueshme dhe me kubëza. Tani po kërkojmë prej juve me marr pëlqim për me shpallë interes të përgjithshëm e me pastaj në një seancë tjetër me marr pëlqim për me rregullua këtë problematikë. Ftojë kuvendaret që pas shqyrtimit të votojnë propozim vendimin e kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, mendoj që propozimi është i qartë pasi kemi të bëjmë me një pjesë të pronës private që është duke u shfrytëzuar për rrugë publike për një lagje të qytetit. Mendoj se është interesi i përgjithshëm dhe interesi i qytetarëve dhe në këtë rast duhet që të aprovojmë dhe të kalojmë kjo pikë që të shpallet me interes të përgjithshëm, e sigurisht edhe hallkat tjera të zingjirit që vijnë me pas për këmbim të pronës. Pra është interesi i përgjithshëm dhe duhet të kalojmë.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë për kontributin z.Cena, e qesim në votim pikën e pestë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

#### **6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për lirim nga taksa komunale për bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit.**

**Artan Asllani** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kuvendarët, kolegë drejtorë, anëtarët e kuvendit dhe gjithë të pranishmit në sallë. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka planifikuar që në këtë seancë të bën në propozim vendimin për lirim nga taksa komunale për bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit. Në këtë vendim parashihet të bëhet lirim i të gjitha bizneseve që janë të ngarkuara sipas rregullores aktuale, ku bëhet fjalë për 451 biznese, përjashtimisht në këtë propozim nuk përfshihen bankat, kompanitë, KEDS-i, barnatoret shëndetësore, pompat e derivateve, kompanitë e sigurimeve. Po ashtu, në këtë propozim është paraparë që të gjitha bizneset që kanë kryer obligimet në raport me komunën për vitin 2020 të bëhet lehtësimi për vitin 2021. Ftojë të gjithë kuvendarët që ta përkrahin këtë propozim vendim.

**Rasim Fazliu** – Sigurisht se për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 edhe më herët janë ngritur këto çështje nga kolegët që bizneseve t'ju ndihmohet në këtë drejtim dhe faktikisht jemi për të ju ndihmuar bizneseve që me lirin nga ngarkesat për taksa afariste por paraprakisht desha me ju pyet se a keni planifikuar se nga do t'i merrni këto mjete pra nga do t'i kompensoni në mënyrë që këto mjete janë të parapara për projekte të ndryshme kur e kemi bërë buxhetimin dhe tash kur të hiqen atëherë ato projekte mbesin pa u realizua për aq mjete sa janë të parapara, bile dy projekte edhe të taksat afariste edhe të qiraja që është pika me vonshme kapet një shumë 116,000 euro. Kështu që a keni paraparë se nga do t'i realizoni këto të hyra për me i realizua ato projekte që janë të parapara me buxhetin kur e kemi aprovua për vitin 2021. Pra kjo ishte pyetja, për ndryshe jemi për me ju ndihmuar bizneseve.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit shumë kryesues, kjo është shumë mirë që po vazhdon me praktikën që kemi filluar nga viti i kaluar për lirim nga taksa komunale e me pas e kemi edhe nga qeraja. E përgëzoj drejtorin që ja ka bërë kërkesën dhe propozimet kryetarit të komunës dhe në këtë rast kryetari i Komunës është propozues tek Kuvendi dhe nuk ka nevojë me ardh dokumenti i drejtorit që ja ka propozua kryetarit, pasi normal që me propozim të drejtorit atëherë kryetari e miraton kështu që ky dokument është i tepërt këtu dhe nuk ka pasur nevojë me ardh. Ne e dimë edhe po e çmojmë se ke bërë një kontribut që je duke punuar mirëpo kjo e kryetarit për të na nuk vlen. Por, megjithatë është mirë dhe sinqerisht unë e mbështes këtë propozim që e kam dhënë në fillim atëherë kur jemi marr vesh vitin e kaluar bashkë edhe i falënderoj të gjithë kuvendarët që më kanë përkrahur atëherë për 3 muaj dhe më pas kemi vazhduar përsëri edhe e mbështes përpos këtë kategorizimin

prapë po e them nuk e di a kemi te drejtë ne me i lirua ashtu siç shkruan banka, kompania KEDS-i për këtë nuk e di, çështja është e certifikimit apo mos certifikimit te vendimit. Në parim e mbështes këtë propozim edhe njëherë ju falënderoj që ka ardh ky propozim këtu.

**Ali Morina** – Është mirë që drejtori na ka bashkëngjitur edhe këtë kërkesën që ju ka drejtua kryetarit edhe çdo informate shtesë që na vjen rreth pikave është e mirë pasi edhe ne informohemi me qartë për çështjet. Unë desha me u ndërlidh pikërisht te kjo kërkesë që i është drejtua kryetarit ku në fund të tekstit thotë, po ashtu ne kemi planifikuar që nëse lirohen këto biznese te ju bëhet edhe propozimi që të gjitha ato biznese që kanë borxhe në taksa afariste e që janë përfitues të këtij propozimi të bëjnë pagesat dhe obligimet e mbetura deri me datën 31.12.2021. A bëhet fjalë këtu për lirimin e obligimeve te mëparshme te këtyre bizneseve edhe nëse ne e kemi për qëllim këtë atëherë ne vendimin përfundimtar që do te marrim, nuk e ke asnjë pikë ku e obligon ata që me pagua borxhin, e që ndoshta është dashtë me përfshi si propozim veç ju bën mirëpo nuk i obligon asgjë. Nëse në këtë vendim e kemi një pikë ku ata obligohen me fshi borxhin paraprak që me gëzua të drejtën e lirimit nga kjo taksë atëherë duhet me fshi borxhin paraprak deri me këtë datë.

**Besë Bytyqi** – Faleminderit kryesues, unë do të doja të dija bazën që me çfarë kriterë është bërë kjo ndarje që ka ardhë deri te pika e dytë, që do të thotë që kompanitë e sigurimeve bankat dhe të tjera biznese nuk lirohen nga taksat komunale. Dua të di konkretisht se si ka dalë drejtori apo ekzekutivi te ky vendim, pastaj çfarë kriterë ka pasur që të lirohen apo mos të lirohen dhe nëse e kemi parasysh që jemi në situatë pandemike edhe të gjitha bizneset kanë pasur shumë pak përfitim, kështu që më lejoni të them se edhe bizneset që janë në pikën e dytë kanë pasur rënie drastike të përfitimeve.

**Artan Asllani** – Faleminderit te gjithëve për pyetjet e parashtruara, pyetja nga Rasim Fazliu rreth kompensimit që do të bëhet në këtë kategori. Ne kemi një numër të madh të firmave që kanë borxhe në Drejtorinë e Ekonomisë dhe ne kemi marr hapat e veprimit edhe para se me ndodh pandemia Covid 19 ku kemi dërguar një numër të madh në përmbarues, edhe të gjithë ata që mbi 40 kontrata që janë të lidhura kemi planifikuar që nëse behet ky lirim të bëhet kompensimi në ato të hyra që do të ndodhin në këtë vit. Po ashtu kemi paraparë që të gjithë ato biznese që kanë obligime nëse lirohen për këtë vit, të paguajnë edhe shuma tjera që kanë mbetur për këtë vit në obligime. Në pyetjen e dytë që e ka shtruar Fehmi Hoxha rreth kategorizimit, ku sipas rregullores për taksa dhe tarifa komunale, e vetmja kategori që merr vendim janë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit që marrin vendim për lirim apo mos lirim. Ne kemi pasur rastin edhe gjatë vitit kaluar, në qershor kur kemi punuar me rregullore, shume prej kuvendareve kanë bërë pyetje se ndoshta nuk do të na kthejnë për shkak se disa i kemi liruar edhe disa jo mirëpo edhe për këtë vit nuk besoj që ka diçka keq edhe që munden me na refuzua. Pastaj pyetja e parashtruar nga Ali Morina, të gjitha bizneset janë të parapara në pikën 3 siç e keni edhe vendimin aty, nuk e kemi largua për të gjitha vitet pasi propozimi është për me ju ndihmua por te paktën për vitin 2020 që me i arrit të hyrat të propozimit për lirim. Pastaj pyetja e parashtruar nga Besë Bytyqi, sipas kategorizimit të pikës 2, ne kemi analizuar mjaft mirë, pasi të gjitha këto biznese edhe përkundër faktit që ka qenë pandemi përjashtimisht ndoshta te kompanitë e sigurimeve që ka qenë një ngecje me herët për 2 apo 3 muaj që nuk kanë mundur të punojnë, mirëpo kemi punuar me një grup punues që nuk e kam bërë vetëm vet këtë propozim që ka lindur ideja që të ngarkohen edhe këto biznese.

**Kryesuesi** – Faleminderit z.Asllani për sqarimet, atëherë kuvendarë të nderuar e qesim në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

## **7. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për lirim nga qiraja mujore për bizneset dhe personat fizik të cilët shfrytëzojnë pronën e paluajtshme të Komunës.**

**Artan Asllani** – Kemi bërë një propozim për lirimin nga qiraja mujore duke përfshirë depot e Matrexit dhe objektet që gjenden në qytetin e Rahovecit. Në këtë propozim bëhet fjalë për 31 qiramarrës që kanë kontrata

me komunën e Rahovecit dhe ne këtë propozim kemi planifikuar që të bëhet lirimi nga qiraja 50% të këtij viti. Të gjitha bizneset që kanë obligime edhe ne këtë propozim për vitin 2020 janë të obliguar që pagesën ta bëjnë për këtë vite. Edhe për këtë pike ftojë kuvendaret që të përkrahet për shkak se ky vite ka qenë sfidë e madhe për te gjitha bizneset që sado pak te ju dalim ne ndihmë ne këto forma te propozimeve.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, gjithashtu edhe këtë pikë e kemi trajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku bëhet fjalë për te gjitha objektet që janë pronë e komunës dhe që janë në shfrytëzim nga qytetarët të lirohen për 50%.

**Fehmi Hoxha** – Siç e dimë që pandemia e ka shkatërruar ekonominë e shtetit dhe shumë biznese të komunës se Rahovecit dhe shumë vdekje si pasojë e kësaj sëmundje. Kështu që ky është propozim shumë i mirë që na vjen këtu ne kuvend, mirëpo unë desha pak të kontribuoj te pika e 3, ku thuhet që te gjitha bizneset dhe personat fizik që kanë kryer obligimet ne raport me komunën për vitin 2020, lehtësimi do të ju bëhet në vitin 2021 ashtu siç është cekur n pikën 1,2 dhe 3 ndërsa ne pikën e 4 obligohen shfrytëzuesit të objekteve komunale dhe lokaleve afariste të cekura ne pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi që obligimet e mbetura të qirasë në vitin 2021 të kryhen me së largu deri më 31.12.2021. Unë mendoj që këtu duhet me nda në dy kuartale për hire të inkasimit të obligimeve që munden me pas. Pjesa e parë që gjithashtu edhe po e propozoj që të bëhet deri 31.06.2021 për hir të inkasimit më të mirë të mundshëm pasi që po i lirojmë 50% atëherë të ndahen ne dy kuartale. Kështu që ai që nuk i ka paguar për 6 muaj për herën e parë nuk ka të drejtë në lirim fare, kështu që pastaj mundet me u marr edhe përmbaruesi. Kështu që sinjerisht është një propozim i mirë dhe besoj që do të më mbështeteni. Krahës këtij propozimi që na ka ardhë këtu që disa herë për lirim, që kemi bërë disa here edhe propozimi juaj edhe i kuvendareve që kanë vendos, kështu që unë kam edhe dy propozime shtesë që konsideroj që është shumë me rëndësi, që e kemi kategorinë e bujqve te cilët janë shfrytëzues të tokës komunale. Kështu që asnjëherë në këtë pandemi bujqit nuk i kemi liru fare që e shfrytëzojnë tokën komunale. Prandaj unë propozoj që në kuadër të propozimit duke ju referuar 50% për qiranë mujore të gjitha objekteve që e shfrytëzojnë, të lirohen shfrytëzuesit e tokës bujqësore pronë komunale njëjtë 50%. Propozoj që sot të merret vendim të lirohen nga qiraja shfrytëzuesit e tokës bujqësore pronë e komunës, bujqit janë kategori sinjerisht më së keqi kanë kaluar pasi nuk kanë mundësi as ku me i plasuar produktet e veta edhe janë ngarkuar edhe me qiranë. Gjithashtu duhet me dal edhe te Drejtoria e Shërbimeve Publike të lirohen për 50% të gjithë shfrytëzuesit e objekteve të përkohshme që janë të vendosura në pronë komunale, kështu që në këtë rast i keni vënë ju aty lokalet e Matrexit, pastaj i kemi barakat dhe kiosqet të vendosura në tërë territorin e komunës së Rahovecit kështu që edhe ata duhet të jenë përfitues nga ky lirim, pasi vërtet kanë një shitje shumë të vogël në ditë. Pra, edhe njëherë po e them se i kam dy propozime shtesë, të lirohen nga qiraja shfrytëzuesit e tokës bujqësore pronë komunale 50% dhe të lirohen 50%shfrytëzuesit e objekteve te përkohshme që janë të vendosura në pronë komunale.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume për kontributin z.Hoxha rreth propozimeve që i bëtë, vërtet bujqit këtë vit kanë pasur probleme rreth plasimit në treg të produkteve të tyre gjatë vitit 2020 po fatmirësisht po i gëzojnë disa privilegje dhe subvencione për bujqësi.

**Artan Asllani** – Rreth propozimit të kësaj pike, te dallimi te pika 3 dhe 4 edhe vitin e kaluar kur kemi marr vendim për lirim nga qiraja, kemi propozua që obligimet e mbetura te paguhen deri me 31.09.2020. Sa për informatë për herë te parë komuna e Rahovecit ne qira saldo borxhe nuk kemi. Kurse te pika e 4 se pse e kemi lanë deri 31.12.2021,vazhdimisht gjatë muajit janar dhe shkurt kemi kërkesë nga bizneset që janë ardhur në drejtori te Ekonomisë që me bo pagesën mirëpo për shkak që e kemi qitë në pikë të rendit të ditës në këtë seancë të muajit shkurt dhe i kemi dhanë hapësirë që mos me i caktua limitet edhe pse po i falim që ndoshta në 6 mujorin e parë me i obligua me pagu. Ndërsa te tokat që janë te lidhura me kontratë kemi debatuar me drejtorin e Bujqësisë dhe gjithashtu edhe me drejtorin e Shërbimeve Publike për hapësirat e jashtme që janë

kontrata te vogla mirëpo edhe ngarkesa është shume e vogël, po supozojmë 1 hektar ne komunën e Rahovecit me se shumti që jepet ne shfrytëzim për bujqit është 100 euro dhe nëse ka te mbjellë me grurë aplikon ne ministrinë e bujqësisë dhe merr subvencion 150 euro.

**Fehmi Hoxha** – Po e shoh që faktikisht nuk e kemi dokumentin dhe propozimin vendimin dhe as vendimin e përgatitur, kështu që atëherë kërkoj nga drejtori i Bujqësisë dhe i Shërbimeve Publike që i kanë evidencat për objektet e përkohshme që janë, që për seancën e radhës te na përgatisin edhe të dalim qoftë edhe në mënyrë simbolike t'i ndihmojmë, kështu që a është 50 apo 100 euro sinjerisht kategoria më e dobët janë bujqit dhe gjithë këta që kanë kiosqet. Atëherë unë do e mbështes këtë propozimin para se të debatojmë por kërkoj që për seancën e radhës të përgatisin një propozim vendim tjetër të kryetarit për kuvend, për lirim të këtyre dy kategorive.

**Kryesuesi** – Faleminderit për kontributin e dhënë z. Hoxha, atëherë të nderuar kuvendarë e qesim në votim pikën e shtatë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

#### **8. Informatë për zonën e mbrojtur “ Kanioni i Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë”.**

**Rumir Zhuniqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë kuvendit, kolegë drejtor. Para dy muajve ne seancën e kuvendit kam paraqitur një informatë mbi gjendjen apo statusin ligjor të zonës së mbrojtur Kanioni i Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë ndërsa sot e paraqes një informatë mbi objektet që janë të ndërtuara në sipërfaqen e zonës së mbrojtur. Informatën e kam ndarë në 3 zona, pra në zonën e parë gjendet restoranti te Ura e Fshejtë bashkë me shtëpiza malore që janë të kontraktuara me komunën e Rahovecit dhe paguajnë qira dhe gjithashtu kanë leje për funksionim. Në zonën 2 është kompleksi memorial i dëshmorëve, pastaj 5 objekte banimi që janë kryesisht në zonën kadastrale te Gexhes dhe 3 objekte te garazhesh që janë ne shërbim te shtëpive te banimit. Ndërsa ne zonën 3 është betonjerka e cila ka pëlqim nga kuvendi i Komunës pastaj janë 2 restorante që nuk funksionojnë përveç një restoranti tjetër që nuk është kuadër të zonës së mbrojtur mirëpo është ne kuadër te departamentit të ujërave dhe në kuadër te Ministrisë se Ekonomisë dhe Ambientit, një objekt banimi dhe 3 objekte industriale që janë te ish ndërmarrjes 1 Maji. Shumica prej objekteve te banimit nuk kanë pëlqim apo leje komunale mirëpo siç e thash betonjerka restoranti e disa te tjera e kanë pëlqimin. Në mbledhjen e KPF-së kolegu Rasim Fazliu ka kërkuar që informata te jetë mbi pronësinë apo pronaret mirëpo ne këtë aspekt unë si drejtor i urbanizmit nuk kam te drejtë mirëpo nëse është e mundshme atëherë drejtorja për gjeodezi pronë dhe kadastrë mund ta jep informatën për pronaret e kësaj hapësirë. Siç e kam cekur ne informatë, shumica e zonës është pronë private.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për këtë informatë që na ka sjellë rreth zonës së mbrojtur Kanioni i Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë. Por, siç e ceku edhe drejtori unë jam i kënaqur me këtë informatë që na ka sjellë drejtori dhe që unë e falënderoj mirëpo kjo nuk i plotëson kërkesat që unë i kam kërkuar dhe unë them te drejtën kam kërkuar nga ekzekutivi pavarësisht se cili drejtor është kompetent që të na sjellë listën e pronarëve që kanë toka sidomos në zonën e ngushtë apo rigoroze siç thuhet dhe siç e dimë që kjo zonë ka rreth 40 hektar që janë në pronësi private ndërsa 84 hektar janë në pronësi shoqërore. Po flas në bazë të dokumenteve që kemi pasur atëherë, ndoshta kanë mundur tash me ndodh ndryshime që nuk mund t'i kundërshtoj por nuk është me rëndësi me u kap për shifra tash, por, e rëndësishme është kjo pasi kërkesa ime ka qenë shumë e qartë e sidomos në zonën e ngushtë apo rigoroze, të gjithë ata që kanë toka aty që me na sjellë emrat e atyre që kanë toka aty por propozimin po e bëj kështu që para se me ardhë shqyrtimi i Kanionit të Drinit të Bardhë, të këtij monumenti natyror dhe para se me marr në vendime të reja do të ishte mirë që së pari me na sjellë listën e gjithë atyre që posedojnë toka aty dhe më pastaj vazhdojmë tutje me procedura. Pra, kjo ishte kërkesa ime, kështu që me këtë që keni sjellë ju, kjo është shumë e përgjithësuar dhe absolutisht nuk kemi informata se cilët njerëz posedojnë toka aty, pra kam kërkuar emrat e njerëzve që posedojnë toka aty.

**Sali Sallteku** – Unë nuk e kam të qartë që një restorant që ekziston aty dhe si punon ai restorant, a ka leje dhe ai jep diçka komunës, po ashtu siç e tha edhe shefi i grupit parlamentar, unë e di që kjo zonë e mbrojtur ka shumë njerëz që e posedojnë me emër e mbiemër dhe do të ishte mirë që me i sjellë këtu emrat e atyre personave që posedojnë këto prona dhe gjithashtu kanë fillua shumë më herët edhe me punua aty para 5-6 vite dhe në qeverisjen e kaluar i kemi ndaluar, kështu që do të ishte mirë me i sjellë emrat e atyre personave që posedojnë këto prona, pasi vërtet ka njerëz që në zonën e mbrojtur me dokumente e kanë me parcela 10, 15,20 ari mirëpo që nuk munden me ndërtua ajo është diçka tjetër, por, e posedojnë dhe do të ishte mirë me i ditë ata me emra.

**Fehmi Hoxha** – Rreth kësaj çështje disa here kemi debatuar se është temë shumë me rëndësi, që unë atëherë ne cilësinë e drejtorit të urbanizmit në qeverisjen Vehapi kam kërkuar mbështetje nga kryetari i komunës me kërkesë dhe pas vizitës se Institutit të Monumenteve Natyrore për vizitën që e kanë bërë Kanionit të Drinit të Bardhë dhe janë kryer të gjitha procedurat dhe është marr vendim nga kuvendi komunal dhe janë zhvilluar të gjitha procedurat dhe e kemi një dokument propozim profesional të Institutit për Mbrojtje të Monumenteve Natyrore atëherë pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kështu që këtë dokument pra këtë plan ne duhet ta sjellim në kuvend propozimin dhe me pastaj këtu debatojmë. Në atë propozim profesional janë me emër dhe mbiemër të gjithë pronarët që janë aty me sipërfaqe e të gjitha. Ashtu si ka qenë më herët në vitin 1986 ku është marr vendim nga dy komunat më herët, tani këtë problem ne duhet ta kryejmë se kemi obligim pasi që e kemi edhe dokumentin bazik të planifikimit hapësinor të zonës së mbrojtur të planit komunal i ri që pason me hartën zonale. Të nderuar kuvendarë dhe ju ekzekutiv, edhe ju e dini që jemi shpallur komuna me e mirë nga DEMOS-i, është peng i Planit Zhvillimor Komunal dhe nuk e di pse po e ngulfasim veten dhe nuk po punojmë bashkë që këtu me ardh ai propozimi, drejtori i fut edhe përgjegjësitë nga Instituti edhe ta debatojmë këtu që ta kryejmë njëherë e përgjithmonë këtë pjesë. Gjithashtu mos harroni se po përmendet prona, unë shumë kam punuar e po besoj edhe drejtori aktual, pasi aty kemi të ndërtuara shumë objekte në zonën e mbrojtur pa leje dhe pëlqim mjedisor. Pastaj Obelisku i komunës është i ndërtuar pa pëlqim mjedisor që e lëshon në këtë rast Ministria e Mjedisit e gjithashtu edhe shumë objekte tjera. Mirëpo kemi shumë prona private të cilave nuk iu lejohet të ndërtojnë asgjë dhe në këtë rast komuna nëse dëshiron ta mbajë atë zonë të mbrojtur për vete atëherë ka obligim me i kompensua të gjithë pronarët që janë aty edhe le të vendos vetë. Kështu që nuk mundet komuna me bo shkelje me ndërtua një objekt kurse ai privat që mos me ndërtua. Pra, na duhet që ta rregullojmë këtë dokument që t'i precizojmë qartë dhe gjithashtu mundemi me caktua se cilën pjesë se çka është e lejuar dhe çka nuk është e lejuar dhe pse mos me u bo zhvillimi i turizmit rural. Kështu që mundemi me u përcaktua bashkë që me dal me një propozim i ekzekutivit më shumë ekspertë edhe ta rregullojmë këtë pjesë. Askush nuk po e thotë në momentin kur merret ndonjë vendim që mund të ndërtohet ndonjë shtëpizë druri p.sh. që nuk hapen biznese te reja dhe aktualisht është e mbyllur. Pra, zona e mbrojtur duhet me pas destinim dhe në këtë rast Kanioni i Drinit të Bardhë patjetër që duhet te jetë i mbrojtur dhe gjithashtu është ligji i ujërave që 150 metra që nuk lejohet afër lumit me u ndërtuar asgjë. Kështu që çfarëdo vendimi që marrim këtu duhet te jetë në përputhje me ligjin e ujërave. Prandaj, ju ftoj që dokumentin që propozimin profesional prej Ministrisë ju e keni dhe sa e di unë e ka edhe kryesuesi, kështu që silleni në kuvend pasi janë me emër dhe mbiemër të gjithë pronarët të cilët kanë qenë më herët dhe të tjerët që kanë marr përmes gjykatës këmbim pronave. Pra, gjithçka është e qartë, pjesa e poshtme 54 hektar dhe pjesa e epërme. Kështu që silleni dokumentin te ecim përpara që ta marrim Planin Zhvillimor Komunal dhe më pas bëhet edhe harta zonale dhe i marrim këto 600,000 euro prej Demosit që është peng i kësaj.

**Kryesuesi** – Faleminderit për kontributin z.Hoxha dhe gjithë të tjerët, gjithashtu edhe për ju drejtor për sjelljen e kësaj informate, të nderuar kolegë kuvendarë kalojmë ne pikën e parë shtesë:

**1. Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 165/21, të datës 29.01.2021 për shpalljen me interes të përgjithshëm në zonën kadastrale Pastasel.**

Të nderuar kolegë kuvendarë, Ministria e pushtetit lokal me datën 21.02.2021 na ka kthyer një vendim te cilin ne duhet ta shfuqizojmë. Pra behet fjalë për parcelën e cila gjendet ne Pastasel ku ne baze te rekomandimit apo arsyes se MAPL-së është ne menaxhimin e agjencionit pyjor te Kosovës.

**Isak Hoti** – Faleminderit kryesues, te nderuar kuvendarë. Ky vendim që na është kthyer nuk do te thotë që është i fundit pasi mendoj se do të na kthehen prapë, pasi kjo është edhe puna e atyre zyrtareve për monitorimin e komunave. Por sikur ta analizojmë mirë vendimin që na kanë kthye, vërtet është shume vështir me i kuptua pasi edhe ata vet nuk kanë dit edhe përgjigje me dhanë, po ashtu edhe komunikimi i drejtpërdrejt aa aty në një te ardhme nëse nuk shfrytëzohet prej banoreve është pjesë e komunës dhe nuk mund te bartet te askush tjetër. Po ashtu edhe me te komplikuar e kanë krijuar situatën kur thotë që ne rast kur prona është në pronësi te komunës nuk është e nevojshme te shpallet me interes te përgjithshëm. Shpallje me interes te përgjithshëm vlen vetëm për rastet kur prona ne baze te fletëve poseduese nuk është ne pronësi te komunës. Listën poseduese keni pasur përpara, PSH.Kosoves, KK.Rahovec, shfrytëzues agjencioni pyjor. Pra problemet me te mëdha i ka Komuna e Rahovecit me agjencionin pyjor. Kështu që nuk janë tregua edhe shume sinqerisht rreth përgjigjes se tyre sa i përket rreth një zgjidhje te këtij problem, kështu që ne jemi te obliguar që edhe pa dëshirën tone me shfuqizua këtë vendim. Kështu që unë e kam te qartë nenin 81, për vetëqeverisje lokale, kanë ligjshmërinë ne akte edhe ata na dërgojnë se kur vjen shkresa, pasi është një shkresë edhe nuk ka asgjë edhe nuk është hera e pare që na dërgojnë ne këtë mënyrë. Por te them te drejtën që nuk jemi edhe komuna e vetme që kemi këso problem me MAPL-në, kështu e pash me patjetër me diskutua me ju se nuk do jetë vendimi i fundit që do te kthehet prej MAPL-së.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z.Hoti, te nderuar kolegë kuvendarë, e qesim ne votim pikën e parë shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë shtesë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dytë shtesë:

**2. Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit Nr.149/20,të datës 29.12.2020, për miratimin e listës për emërtimin e rrugëve dhe shesheve ne Komunën e Rahovecit.**

**Besa Bytyqi** – Faleminderit kryesues, te nderuar kolegë kuvendarë, drejtor te drejtorive. Ne kemi marrë një kërkesë nga MAPL-ja lidhur me emërtimet e reja te rrugëve shesheve dhe parqeve. Pas kërkesës nga ministria, ne si komision jemi takuar dhe e kemi shqyrtuar ne detaje dhe ne përpikëri rekomandimet e Ministrisë dhe kemi përmirësuar te gjitha detajet dhe tani kemi sjellë ne kuvend me përmirësime siç janë hartat e rrugëve që janë te shfaqura ne monitor dhe përshkrimet e propozimeve te 21 rrugëve dhe 9 parqeve e shesheve ne komunë. Pra ne monitor mund të i shohim bashkërisht detajet hartat dhe gjithashtu i kemi edhe propozimet. Ju ftoj që pas shqyrtimit që ti votojmë.

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, natyrisht që e përkrahi propozimin e kryesues se komisionit , ku ne propozimin e vitit te kaluar ka qenë e përfshirë edhe një rrugë ne fshatin Ratkoc, gjë te cilën sipas rekomandimit te agjencionit kadastral te Kosovës nuk është e mundur me u bo ai ndryshim, kështu që unë e inkurajoj kryesuesen e komisionit dhe komisionin ne përgjithësi që te merren prape me çështjen e asaj rruge sepse ka modalitete që ajo rruge mundet me u bo ashtu por kërkohej disa elemente te vogla me u rregullua ne sistem dhe ajo rruge te merr emrin e vet.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Morina, e qesim ne votim pikën e dytë shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e dytë shtesë.

**3. Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit, drejtoreshës dhe zëvendësdrejtoreshës si institucion edukativo arsimor.**

**Avni Morina** – Faleminderit kryesues, te nderuar kuvendarë. Kemi në proces një konkurs për përzgjedhjen e drejtoreshës të shkollave ne 6 shkolla te komunës tonë. Konkursi është ne procedurë dhe bazuar në udhëzimin administrativ te fundit te nxjerrë nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, sipas udhëzimit administrativ nr.151/2020.Konkretisht sipas nenit 6,pika 3 ku flitet për komisionin përzgjedhës për institucionet arsimore që janë në varësi te komunës dhe flitet për përbërjen e komisionit. Në këtë përbërje thuhet që DKA ti propozoj

kuvendit për miratim dy anëtar të komisionit, gjithashtu komisioni ka edhe anëtare të tjerë siç e ka edhe nga këshilli i prindërve, një anëtarë është edhe nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, por dy anëtarët që propozohen nga DKA-ja duhet të merret aprovimi nga kuvendi. Këta dy anëtarë janë në baze të këtij udhëzimi administrativ pika 3.1 dhe këta dy anëtarë janë të propozuar njeri nga DKA-ja dhe njeri nga një institucion arsimor e që konkretisht bëhet fjalë për Lulzim Krasniqin që është zyrtar i DKA-së dhe Sakip Kryeziu që është drejtor i shkollës "Isa Boletini". Mandati i këtyre anëtarëve të komisioneve është deri 1 vit që mund të jetë edhe më i shkurt por propozimi jonë është deri 1 vit në bazë të udhëzimit administrativ. Pra të dy anëtarët e komisionit kanë mandat sipas udhëzimit administrativ edhe nëse i aprovojmë për 1 vit. Kërkoj nga kuvendarët që të përkrahni këtë propozim të DKA-së për emërimin e dy anëtarëve të komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor shkolle.

**Ali Zhuniqi** – Te kjo pikë e rendit të ditës po më intereson, meqenëse edhe varet prej neve përzgjedhja për me u aprovue në kuvend, dua të di se kush ka qenë propozues i dy emrave të parë, më intereson të di, pasi siç e shoh të dy emrat janë me ngjyra politike dhe në konsiderojmë se të njëjtit mundën me bo zgjedhje të duhur të përzgjedhjes së drejtorëve nëpër shkolla. Kështu që e konsiderojmë që ky propozim nuk mundet me u kalua.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, e falënderojmë drejtorin për propozimin që e dhëmë, kështu që në mendojmë se propozimi është shumë me vend pasi edhe është personi që punon në DKA dhe gjithashtu është edhe person zyrtar dhe poashtu edhe prej drejtorëve duhet me patjetër me qenë njëri prej tyre, kështu që konsideroj se duhet me respektua ligjin dhe me i respektue rregullat ashtu siç duhet dhe në jemi për me mbështet këtë propozim të drejtorit të drejtorisë së arsimit si grup i PDK-së.

**Faton Ramadani** – Faleminderit kryesues edhe unë mendoj njëjtë sikur parafolësi, pasi që janë dy njerëz adekuat që janë në listë dhe që kanë dhënë kontribut deri më tash për arsimin, kështu që Sakip Kryeziu e njohim pasi është një njohës dhe udhëheqës i mirë i arsimit, kështu që mendoj se duhet përkrahur këta dy që të jenë pjesë e këtij komisioni dhe e mbështesim.

**Kryesuesi** – Të nderuar kolegë kuvendarë e qesim në votim pikën e tretë shtesë të rendit të ditës. Konstatoj se me katër vota abstenim, aprovohet pika e tretë shtesë e rendit të ditës.

Te nderuar kuvendarë, duke ju falënderuar të gjithëve për kontributin, tani fjalën e ka z. Qazim Qeska.

**Qazim Qeska** – Faleminderit kryesues, unë kam një fjalim shumë të shkurtër i cili nuk do të ketë fare karakter zyrtar por një karakter sipas meje human apo moral. Qëllimi i këtij diskursi tim shumë të shkurtër është që juve kolegë të nderuar si bashkanëtarë të kuvendit të Komunës së Rahovecit. Kam dëshirë që të ju përshëndes dhe të ju falënderoj për zemërsisht për faktin se unë formal juridikisht detyrën time si këshilltar i kuvendit të Komunës së Rahovecit e kam përfunduar, për faktin se ligji mbi konfliktin e interesit i cili ka hy në fuqi në qershor 2018, me paraqet një konkluzion me detyrën time që e kam si avokat i licencuar. Ndaj unë përkundër vullnetit tim besoni kam marr vendimin e prerë që të vazhdoj me detyrën e avokatit të licencuar në zyrën time në Rahovec. Ndërsa në këtë moment kur ju drejtohem juve, ta përfundoj detyrën e zyrtarit të lartë ashtu siç thotë ligji për konfliktin e interesit apo detyrën e këshilltarit. Të nderuar kolegë, ju përshëndes të gjithëve duke ju dëshiruar shëndet dhe punë të mbarë në punën tuaj si këshilltarë deri në përfundimin e këtij mandati të këtij sesioni. Ju falënderoj për kontributin që e kemi dhënë të gjithë së bashku dhe bashkëpunimin që kam pasur me juve dhe isha krenar që kam qenë pjesë deri në këtë momentin e sesionit të kuvendit të komunës së Rahovecit prej zgjedhjeve të vitit 2017. Ju dëshiroj shëndet dhe punë të mbarë në interes të qytetarëve që ju këtu i përfaqësoni. Koleg të nderuar prej këtij momenti të unë do ta keni vendin e një miku në çdo kohë edhe në çdo vend, për kundër faktit që unë këtu edhe zyrtarisht e përfundoj mandatin e këshilltarit të kuvendit të Komunës së Rahovecit duke ju falënderuar të gjithëve, kryetarin e Komunës bashkë me bashkëpunëtorët e tij, drejtorët që e kryejnë detyrën në interes të qytetarëve të Komunës dhe gjithë kolegët që kemi bashkëpunuar në këto 3 vite e gjysmë e në veçanti e përshëndes kryesuesin e Kuvendit i cili në këtë mandat detyrën e kryesuesit e ka

krye ne nivelin më të lartë profesional duke respektuar ligjin për vetëqeverisje lokale, statutin e komunës, rregulloren e kuvendit të Komunës e mbi të gjitha sipas bindjes sime me moral të lartë dhe me një durim të pashoqë duke na dëgjuar të gjithë neve këtu. Ndaj edhe njëherë ju përsëndes dhe ju falënderoj, gjithashtu kërkoj mirëkuptimin tim nëse në ndonjërin prej seancave të kaluara, diskursi im nuk ka qenë në nivelin që është dashtë por të gjitha që mund të këtë bërë ndonjë lëshim e keni pasur mirëkuptimin tim. Falënderoj të gjithëve, ju dëshiroj shëndet edhe punë të mbarë.

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, me te vërtet nuk kam qenë paraprakisht i informuar për këtë dhe e mora si befasi, gjithsesi të urojmë shëndet dhe punë të mbarë prej avokati. Ka qenë kënaqësi për mua personalisht por edhe për kolegët e mi të grupit që kemi qenë bashke në kuvendin komunal dhe për bashkëpunimin e ngushtë që kemi pasur për të gjitha pikat, pa marr parasysh që në ndonjërin që kemi mundur me pas mospajtime mendimesh, unë e vlerësoj lartë kontributin tuaj dhe në emër të grupit të AAK-së të falënderojmë dhe të urojmë shëndet dhe punë të mbarë në punën tuaj si avokat.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, edhe për mua dhe grupin tonë ishte një befasi kjo jo e këndshme me keqardhje që delegati nga grupi i PDK-së z. Qazim Qeska nga sot po e përfundon mandatin e tij. Mendoj që të gjitha ato që i tha ai vet, qëndrojnë plotësisht edhe ne kemi pasur respekt e sigurisht se do të kemi respekt të veçantë për z. Qeska dhe kontributin e tij, po ashtu mendoj që do të na mungoj për këtë periudhë sa na kanë mbetur deri në përfundim të mandatit tonë, por sidoqoftë ligji e parasheh kështu dhe ai është njeri që gjithmonë e ka respektuar dhe po shihet se po e respekton ligjin. Në emër të grupit të LDK-së i dëshirojmë shëndet dhe punë të mbarë në rrugëtimin në profesionin që e ka si avokat i pavarur dhe i licencuar.

**Dervish Çadraku** – Përsëndetje kryesues, gjithashtu edhe për mua dhe grupin tonë ka qenë befasi pasi pak me herët dëgjova mirë për veprimin e z. Qeska. Me z. Qeska njihemi qysh moti dhe e vlerësoj shumë karakterin dhe punën e tij që e ka bërë deri me sot, e po ashtu edhe këtu në kuvend ka bërë një punë shumë të mirë dhe ka qenë shumë kolegial dhe unë e kam respektin e veçantë por unë dua në emrin tim dhe në emër të grupit tonë Vetëvendosje që ta falënderoj për punën e deritashme dhe i dëshiroj shëndet të mirë e suksese në punën e mëtejshme si avokat.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, për z. Qeska kemi shumëçka me fol pasi vërtetë ka qenë një njeri i mirë dhe një anëtar i kuvendit kontributdhënës dhe falënderoj për krejt punën që ka bërë këtu edhe kuvendit të Komunës së Rahovecit vërtet do t'i mungoj për këto muaj sa jemi deri në fund të mandatit një jurist dhe avokat i mirë i cili ka dhënë kontributin e vet atëherë kur ka pas nevojë mendimi i tij që të dëgjohet. Mirëpo ajo që është më e rëndësishme se z. Qazim Qeska qëndron mirë me shëndet dhe ne i dëshirojmë në rend të parë shëndet dhe punë të mirë në profesionin prej avokatit që ka dhe i shkoftë mbarë më tutje.


**Kryesuesi** – Të nderuar kolegë kuvendarë, siç e vërejtët edhe vet me shumë vështirësi e ftova kolegun tonë z. Qeska, meqenëse kolegu ynë para dy dite ishte në zyrën time dhe më informoi për proceset që do të vijnë dhe të them të drejtën unë kërkoja në mënyrë kolegiale që të bën pezullimin e punës tjetër andej për shkak që për këtë kohë sa jemi bashkë si me z. Qeska dhe me gjithë të tjerët vërtetë kemi qenë shumë konstruktiv dhe jemi munduar me dhanë kontributin më të mirë dhe më të madhin të mundshëm për qytetarët tanë e në veçanti kur janë sikur ish kryetari i Komunës tonë z. Qazim Qeska. Vendimin që ka marr kolegu ynë është vendim që me patjetër është dashtë me zgjedh mirëpo çështja e ushtrimit të detyrës së profesionit të z. Qeska e sheh me të arsyeshme që ai me vazhdu punën edhe rrugëtimin e tij në profesionin e vet prej avokati. I nderuari z. Qeska për mua si kryesues dhe si koleg i juaji ishte nder që pata mundësi për këtë kohë gjatë këtyre viteve të punojmë se bashku dhe gjithsesi edhe për kolegët tjerë kur kemi këso njerëz që na udhëzojnë rreth rrugës që të punojmë sa me drejtë dhe ta respektojmë ligjin e posaçërisht për neve me të rinj është një shembull jashzakonishtë i mirë që duhet ta ndjekim të gjithë. Z. Qeska të uroj shëndet të mirë dhe ju falënderoj për

kontributin si koleg që kemi qenë bashkë. Urime e suksese në punën e mëtutjeshme në profesionin tuaj. Kështu që të nderuar kolegë kuvendarë, faleminderit shumë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

01-Nr.177/21

Datë: 29.03.2021

Procesmbajtësi:

  
Agim Hoti

